



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 48, Datë 07.03.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR PERIUdhËN 5-VJEÇARE (2018 - 2022)

Në mbështetje të neneve 16; 20 gërmat “a” dhe “e” dhe nenit 75 të Ligjit nr. 43/2015 *Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”; neneve 9 dhe 10 të *Rregullores për Procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 135, datë 06.09.2017, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 07.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e Planit të Investimeve të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për periudhën 5 vjeçare (2018 - 2022),

Konstatohet se:

- Me shkresën me nr. 808 Prot., datë 15.01.2018, OSHEE sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s, Planin planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 5-vjeçare (2018 - 2022)
- Grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr. 14, datë 01.02.2018 të Kryetarit të ERE-s, shqyrtoi aplikimin e dërguar nga shoqëria OSHEE sh.a., duke konstatuar se Plani i zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 5- vjeçare (2018 - 2022):
 - Paraqitet i ndarë sipas kategorive dhe zërave të shoqëruara me vlerat përkatëse financiare për investimet që priten të realizohen gjatë periudhës 5 vjeçare (2018-2022);
 - Përmirëson shërbimin e furnizimit me energji elektrike, të konsumatorëve në sistemin e shpërndarjes;
 - Bazuar në relacionin e dërguar nga OSHEE sh.a. do të ketë impakt në uljen e humbjeve teknike edhe jo teknike;
 - Ndikon në mbajtjen e parametrave teknik të furnizimit me energji elektrike të parashikuara dhe në Kodin e Shpërndarjes së energjisë elektrike;
 - Plotëson dhe përmirëson sistemin e matjes në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike;

- Parashikon periudha kohore të zbatimit të investimit për ndërtimet apo reabilitimet e investimeve përkatëse.
- Mbetet problematik zbatimi i rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve, i cili duhet të shoqërohet me:
 - informacion të plotë lidhur me investimet e realizuara nëpërmjet Partneritetit Publik Privat, kontratat dhe detyrim/realizimet.
 - informacion mbi financimin dhe burimin e këtyre financimeve për realizimin e planit të investimeve për periudhën 5 vjeçare (2018-2022) si dhe periudhat e shlyerjes së këtyre investimeve.
 - Miratimin e Keshillit Mbikqyres për Planin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 5- vjeçare (2018 - 2022)
- Në zbatim të nenit 75 të Ligjit nr. 43/2015, “*Për sektorin e energjisë elektrike*”, ERE ka detyrimin të miratojë planin e investimit për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, për pesë vitet e ardhshme kalendrike, i cili përcillet në ERE për miratim, pas hartimit nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e Planit e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 5- vjeçare (2018 - 2022)
2. OSHEE sh.a. të depozitojë pranë ERE-s dokumentacionin dhe informacionin e munguar sipas konstatimeve në këtë vendim.
3. OSHEE sh.a. duhet të paraqesi të përditësuar planin e investimeve konform nenit 75 të Ligjit nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”
4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTAR I BORDIT TË ERE**

Erjola SADUSHI